



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

**PROGRAMET E KURRIKULËS PËR SHKOLLËN E MESME TË GJUHËVE
TË HUAJA (GJIMNAZ GJUHËSOR)**

FUSHA: GJUHË E HUAJ

LËNDA: GJERMANISHT

KODI: 3.3.11.Zgj.(av)

**PROGRAMI I LËNDËS
GJERMANISHT
PËR KLASËN E 12-TË**

Koordinatorë: Erifili Hashorva

Redaktore letrare: Vjola Grillo

Përgjegjëse sektori: Marita Hamza

TIRANË, NËNTOR 2010

Programi i gjermanishtes së avancuar në klasën e 12-të është menduar të zhvillohet me dy orë në javë. Me anë të këtij programi, nxënësit e shkollave të mesme të gjuhëve të huaja do të kenë mundësinë të thellojnë dhe të avancojnë njohuritë e gjuhës gjermane në bazë të interesave të grupmoshës.

Programi i avancuar ka si objektiv kryesor komunikimin në gjuhë të huaj në situata të ndryshme.

Theksohet se mësimi i gjermanishtes duhet t'u përgjigjet synimeve të arsimit në shkollat shqiptare. Ai duhet të kontribuojë në aftësimin e nxënësve për modelimin madhor të aftësive të tyre.

Në bazë të njohurive të përfuara nga ky program nuk mundësohet vetëm rritja e njohurive të nxënësit në gjuhën gjermane, por edhe në lëndët e tjera, si, p.sh., në lëndët e historisë, të gjeografisë, të biologjisë etj., duke i ndërthurur dijet në mënyrë logjike.

Kjo përzierje ndër-lëndore fiton përmasa të reja në përpjekjen për të siguruar dije të qëndrueshme dhe të vazhdueshme, të cilat e përgatitin nxënësin t'u bëjë ballë studimeve të mëtejshme, si dhe ofertave të ndryshme të punësimit brenda dhe jashtë vendit.

1. SYNIMET

Programi i avancuar i gjermanishtes për klasën e 12-të do të synojë një thellim dhe avancim të nivelit **B2** (duke synuar C1 në aftësi të veçanta):

- Të thellojë dhe të avancojë pavarësinë dhe individualitetin intelektual, shoqëror e kulturor të nxënësve të kësaj grupmoshe dhe të nxisë krijimtarinë dhe mënyrën alternative të menduarit.
- Të rrisë dhe të avancojë aftësinë e veprimit gjuhësor në situata autentike komunikative, nëpërmjet një mësimi më të thelluar të orientuar për veprim.
- Të zënë një vend të rëndësishëm në orën e mësimi materialet autentike, duke përfshirë këtu materiale të medias së shkruar dhe audio-vizive për të hyrë në kontakt me folës nga vendet gjermanishtfolëse.

2. OBJEKTIVAT E PËRGJITHSHËM

Programi i avancuar do të zhvillojë te nxënësit thellimin dhe avancimin në nivelin B2:

- shkathtësinë me shkrim dhe me gojë;
- saktësinë me shkrim;
- aftësinë për të lidhur situatat gjuhësore të krijuara në klasë me ato të jetës reale;
- aftësinë për të bërë dallimet ndërmjet kulturave të ndryshme;
- bashkëveprimin përmes punës në grup dhe shprehive të një pune të pavarur individuale dhe krijuese.

3. OBJEKTIVAT SIPAS STANDARDEVE

Objektivat e programit të avancuar për klasën e 12-të zërthehen hollësisht sipas njësisë mësimore dhe aftësive gjuhësore si më poshtë:

a) Objektivat sipas standardit në komunikim

Objektivat e standardeve në këtë fushë krijojnë bazat e gjuhës, të cilat janë domosdoshmëri për një komunikim me një standard të lartë gjuhësor.

Standardi në këtë fushë pasuron dijet e përgjithshme të nxënësit dhe e përgatit atë emocionalisht për një përballje reale me gjuhën dhe kulturën.

Standardi	Objektivat
Komunikimi	<p>Në fund të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none">• Të diskutojë fakte, ide dhe përvoja, duke përdorur një fjalor të larmishëm, struktura dhe referime kohore;• të flasë me shumë besim me shqiptim dhe intonacion shumë të mirë;• të bashkëveprojë rrjedhshëm dhe në çdo rast me folës vendës të mundshëm pa vështirësi për bashkëfolësin;• të shpjegojë pikëpamjet e tij për një çështje të ditës, duke pasur parasysh përparësitë dhe vështirësitë për çështje të ndryshme;• të respektojë ritmin dhe intonacionin e frazës;• të shprehet, duke perifrazuar shumicën e temave;• të bëjë komente, duke mbrojtur opinionet e tij e duke paraqitur argumente;• të theksojë informacionet që atij i duken me interes.
Veprimtaritë e komunikimit	<p>Në fund të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none">• Të përballojë situata të ndryshme edhe në sektorin publik (p.sh., banka, posta etj.);• të shkëmbejë informacion edhe në situata jo shumë të njohura dhe për tema aktuale e të rëndësishme;• të shprehë mendime, duke bërë komente e duke dhënë argumente;• të krijojë kontakte sociale dhe lidhje në një formë gjuhësore të përshtatshme;• të shpjegojë duke dhënë mendime për tema të caktuara, pa përgatitje të posaçme;• të krahasojë alternativa me bashkëfolësin dhe të zgjidhë probleme të ndryshme;• të diskutojë fakte, ide dhe përjetime, duke zotëruar me besim fjalor, struktura dhe referime kohore të larmishme;

	<ul style="list-style-type: none"> • të përfshihet në biseda të specializuara, të rrjedhshme, në përputhje me interesat e veta; • të flasë me besim për shoqërinë bashkëkohore të vendit, gjuhën e të cilit mëson.
--	--

b) Objektiva sipas standardit në kulturë

Standardi	Objektivat
Kulturë	<p>Në fund të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përcaktojë ndryshimet, duke bërë analogjitë me dy kulturat; • të shprehë kureshtjen për zakonet, traditat dhe kulturën e re; • të kuptojë sistemin shkollor gjerman dhe pikat e përbashkëta e të veçanta me sistemin e vendit të tij; • të njohë historinë dhe kulturën e vendit të gjuhës së re; • të diskutojë mbi jetën dhe veprat e personaliteteve të fushave të ndryshme të kulturës, shkencës, modës, muzikës gjermane etj.

c) Objektivat sipas standardit në formimin gjuhësor

Përshkrimi: Objektivat e standardit në këtë fushë e aftësojnë nxënësin të prodhojë elemente gjuhësore që i përkasin thellimit të nivelit B2.

Në këto orë të mësimin të avancuar duhet të bëhet një punë më e thelluar dhe e avancuar për përvetësimin e saktë të njohurive të para të gramatikës gjermane, në funksion të komunikimit.

Standardi	Objektivat
Elemente gramatikore	<p>Në fund të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të përdorë saktë ligjëratën e zhdrejtë; • të përdorë lidhoren 2 në të shkuarën dhe në të tashmen të të gjitha foljeve; • të përdorë foljet funksionale; • të përdorë fjalitë pyetëse jo të drejtpërdrejta me përemrat pronorë;

	<ul style="list-style-type: none"> • të përdorë saktë fjalinë e nënrenditur lidhore; • të bëjë përshkrimin e një libri apo të një filmi, duke përdorur edhe lidhëzat dygjymtyrëshe; • të përdorë pjesoren e shkuar dhe të tashme; • të përdorë pjesëzat dhe fjalët modale në fjali; • të përdorë saktë mbiemrat e emëruar pas përemrave të papërcaktuar.
--	---

4: OBJEKTIVAT SIPAS AFTËSIVE GJUHËSORE

Aftësia	Objektivat
Të dëgjuarit	<p>Në fund të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të kuptojë në detaje çfarë i thuhet me një gjuhë të folur standarde, qoftë dhe në mjedis me zhurma; • të ndjekë një mësim ose një bisedë të fushës së tij, nëse subjekti i bisedës është i njohur dhe paraqitja e saj është e drejtë dhe e strukturuar qartë; • të kuptojë dokumentarë televizivë, intervista të drejtpërdrejta dhe pjesën më të madhe të filmave në gjuhën standarde; • të kuptojë idenë kryesore të një bisede komplekse me subjekt konkret ose abstrakt në gjuhën standarde, duke përfshirë diskutime të fushës me interes për të; • të kuptojë mesazhin me anë të strategjive të shumta, duke përfshirë këtu të dëgjuarit e pjesëve kryesore.
Të folurit	<p>Në fund të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të marrë pjesë në një bisedë, duke marrë e duke i dhënë fjalën bashkëbiseduesit në mënyrë të natyrshme; • të shkëmbejë informacione të detajuara për tema që paraqesin interes për të; • të shprehë emocionet me intensitet të ndryshëm, duke theksuar atë që është më e rëndësishme për të, në një ngjarje apo në një përvojë; • të marrë pjesë aktivisht në një bisedë disi të gjatë për shumicën e temave me interes të përgjithshëm;

	<ul style="list-style-type: none"> • të mbrojnë opinionet e tij në një diskutim me anë të shpjegimeve duke paraqitur argumente; • të bëjnë supozime për shkaqet dhe pasojat në një situatë të caktuar; • të përmbledhë gojarisht përmbajtjen e një buletini informacionesh, të një interviste, të një reportazhi; • të bëjnë përmbledhjen e ngjarjes së një pjese teatrale, të një filmi apo të një romani.
Të lexuarit	<p>Në fund të klasës së 12-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të lexojë artikuj e raporte për probleme të ndryshme bashkëkohore, ku shkruesi mban dhe shpreh qëndrime e pikëpamje të caktuara; • të kuptojë me hollësi tekste që përmbajnë informacionin e dëshiruar të lidhur me disiplina të veçanta shkollore dhe profesionale; • të kuptojë çështjet kryesore të korrespondencave që trajtojnë probleme të ndryshme të fushave të interesave të tij; • të kuptojë motivet e personazheve, si dhe rolin e ndikimin e tyre në zhvillimin e mëtejshëm të subjektit, duke lexuar një prozë apo një dramë; • të kuptojë përmbledhje e recensione për tema dhe çështje të ndryshme kulturore, si; filma, pjesë teatrale, libra, koncerte etj.

5. KËRKESA TË GJUHËS GJERMANE NDAJ LËNDËVE TË TJERA

Programi i avancuar i gjuhës gjermane për klasën e 12-të mbështetet në integrimin ndërlëndor, duke e shfrytëzuar atë për aftësimin në rritje të nxënësve në përdorimin e njohurive gjuhësore, në përgjithësi dhe të katër aftësive (dëgjimit, leximit, të folurit e të shkruarit), në veçanti.

Konceptet dhe njohuritë e tjera gjuhësore trajtohen e mësohen më mirë në kontekste të caktuara kuptimore, që lidhen ngushtë me fusha tematike të parashtruara në programin e gjuhës gjermane e të trajtuara në lëndët e tjera.

Gjeografia, me njohuritë e saj, i pajis nxënësit me informacione për vendet gjermanishtfolëse (Gjermani, Austri, Zvicër), vendet turistike, peizazhin, veprat e artit dhe i afron ata më tepër me kulturën e këtyre vendeve. Nxënësit do të mësojnë për klimën, relievin, lumenjtë etj. të këtyre vendeve.

Sociologjia i ndihmon nxënësit të njohin dhe të kuptojnë më mirë zakonet, kulturën, traditën e këtyre vendeve. Ata do të ndërjegjësoheshin më shumë për diversitetin e kësaj bote dhe do të bëheshin me të ndërjegjëshëm, më tolerantë, duke kuptuar dhe thelbin e mentalitetit të këtyre vendeve.

Historia, nëpërmjet informacioneve të saj, i afron nxënësit më tepër me historinë gjermane. Ngjarjet e rëndësishme historike, që shënuan fatin e shumë vendeve në botë dhe të vetë

Gjermanisë, do t'i ndihmonin nxënësit të formonin mendimin e tyre për këto ngjarje, duke kultivuar tek ata një mendim kritik.

Edukimi mjedisor: Ndotja dhe mbrojtja e mjedisit janë tema që shoqërohen me fjalor e struktura gjuhësore, të cilat trajtohen jo si një qëllim më vete, por në një kontekst kuptimplotë dhe edukativ.

Edukimi kulturor dhe etik: Dy lëndët kryesore, gjeografia dhe historia, do të ndikonin në formimin kulturor dhe etik të nxënësve nëpërmjet njohurive të trajtuara prej tyre. Zakonet, kultura dhe traditat e këtyre vendeve do të kultivonin te nxënësit aftësinë për të kuptuar më mirë njerëzit, kulturën dhe mentalitetin e këtyre vendeve.

Edukimi për të drejtat e njeriut: Njohja e kulturave të vendeve gjermanishtfolëse realizohet e lidhur ngushtë me temat e barazisë sociale, të mosdiskriminimit social, të respektit reciprok etj., duke i bërë nxënësit më tolerantë me njëri-tjetrin.

6. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Programi i avancuar i gjuhës gjermane për klasën e 12-të është dokument zyrtar, si pjesë e tërësisë së dokumenteve zyrtare për lëndën e gjuhës gjermane dhe duhet të zbatohet nga mësues, autorë të teksteve etj.

Dokumentet e tjera kryesore janë:

- Kuadri i Përbashkët European i Referencave për Gjuhët.
- Kurrikula Kombëtare e Gjuhëve Moderne për Arsimin Publik Parauniversitar.

Për të siguruar përdorimin sa më të mirë të programit, është e vlefshme njohja me dokumentet e lartpërmendura.

Programi i avancuar i klasës së 12-të orienton gjithë procesin e mësimdhënies e të nxënies së gjuhës gjermane në nivelin B2.

A) Objektivat

Objektivat e këtij programi, me anë të të cilit nxënësit thellojnë njohuritë dhe avancojnë në mësimin e gjuhës gjermane, janë detyrim për përdoruesit e programit.

B) Orët mësimore

Në programin e thelluar në lëndën e gjuhës gjermane, afërsisht **70%** e orëve mësimore totale janë për thellimin e njohurive të reja lëndore dhe **30%** e tyre janë për përpunimin e njohurive (gjatë vitit shkollor dhe në fund të tij).

Shpërndarja e orëve

Programi parashikon shtrirjen e mësimit të gjuhës gjermane në të gjithë vitin shkollor dhe do të realizohet në 68 orë mësimore, me një frekuencë prej 2 orësh në javë, në 34 javë mësimore:

34 javë x 2 orë = 68 orë vjetore.

Shpërndarja e orëve të planifikuara është si vijon:

Komunikimi dhe formimi kulturor zënë 48 orë, të cilat ndahen, sipas objektivave që u përgjigjen, në 34 orë mësimore për kulturën dhe komunikimin (70% e tyre, që përbëjnë 24 orë, do të jenë për trajtimin e lëndës së re, kurse 30% e tyre, që përbëjnë 10 orë, do të shërbejnë për përpunimin e njohurive. Me përpunim do të kuptojmë, p.sh., përforsimin e informacionit të marrë në temat përkatëse ose ushtrime për mendimin kritik rreth këtij informacioni). Aktet dhe funksionet e komunikimit do të jenë 14 orë (70% e tyre, që përbëjnë 10 orë mësimore, do të shërbejnë për njohuritë e reja, kurse 30% e tyre, d.m.th. 4 orë mësimore, do të përdoren për përpunimin e njohurive. Këtu mësuesi bën përpunim njohurish për integrimin tërësor të lëndës. Ai jep detyra komplekse, ku pasqyrohen njohuritë e përfuara sipas aftësive dhe objektivave në një kapitull).

Formimi gjuhësor zë 20 orë. Në këto orë, mësuesi shtjellon, në bashkëveprim me nxënësit, njohuri gramatikore dhe ushtrime gjuhësore gramatikore e leksikore (70% e tyre, që përbëjnë 14 orë mësimore, do të shërbejnë për trajtimin e strukturave të reja, kurse 30% e tyre, që përbëjnë 6 orë, do të shërbejnë për rimarrjen, përpunimin dhe përforsimin).

Përmbajtja mësimore e lëndës së gjuhës gjermane për klasën e 12-të të shkollave të mesme të gjuhëve të huaja realizohet duke synuar B2.

Këtu duhet mbajtur parasysh, sigurisht, edhe përdorimi i gjuhës nga nxënës/i,-ja, pra përvetësimi i aftësisë pragmatike që do t'i lejojë atij/asaj ta përdorë gjuhën sipas qëllimeve të caktuara. Gjithashtu, formimi gjuhësor duhet të privilegjojë aftësitë komunikative të gjuhës, larg formave të mësimit tradicional të gramatikës.

Përpunimi i njohurive

Përpunimi i njohurive përmban:

- Përsëritjen e njohurive, thellimin dhe avancimin e tyre.
- Testimin e njohurive të avancuara.
- Integrimin e njohurive të thelluara të lëndës me njohuritë e marra.
- Integrimin e aftësive të reja me njohuritë e lëndëve të tjera (Ndonëse këto integrame do të përshkojnë zhvillimin e çdo ore mësimore, gjatë përpunimit u duhet kushtuar kohë e posaçme).
- Përsëritjen vjetore.
- Testimin vjetor (nuk është i detyruar).

Gjatë përpunimit të njohurive të thelluara, duhet t'i kushtohet kohë e posaçme:

- kultivimit të aftësive të përgjithshme, si: të komunikimit, të menaxhimit të informacionit, të zgjidhjeve problemore, të menduarit kritik dhe krijues;

- kultivimit të aftësive të posaçme lëndore, si: komunikimi gojor, shkrimi riprodhues e krijues, kuptimi i teksteve me vështirësi dhe gjatësi mesatare, kalimi nga kuptimi thelbësor tek ai më i detajuar, kuptimi me gojë dhe ndërveprimi bisedor etj.;
- formimit të qëndrimeve, si qëndrimi etiko-social.

Metoda dhe strategji të mësimdhënies/mësimnxënies

Të dëgjuarit

- Të kuptojë tregime të shkurtra dhe fragmente nga gjuha e folur, si dhe të zhvillojë të dëgjuarit në mënyrë të pavarur;
- të kuptojë mirë dhe t'i përgjigjet një larmie materiali faktik ose jofaktik të marrë nga programet televizive;
- të përthithë pa vështirësi të gjithë informacionin e nevojshëm nga jeta e përditshme;
- të kuptojë gjuhën e artikuluar me shpejtësi normale, si dhe materialet që përmbajnë repertor gjuhësor të panjohur.

Të folurit

- Të marrë pjesë në një bisedë të rastit, të krahasojë realitete dhe të interpretojë e të riformulojë informacione me mendimet e veta;
- të argumentojë mendimet e tij me një fjalor të pasur;
- të shprehet për tema të ndërlikuara në mënyrë të qartë dhe të strukturuar dhe të përshtasë të folurit sipas qëllimit të tij dhe kontekstit, duke folur me ritëm dhe me intonacionin e kërkuar nga situata;
- të tregojë se kupton mirë materiale të ndryshme leximi, që përmbajnë leksik e struktura të panjohura, të shkëputura nga burime të ndryshme.

Të lexuarit

- Të kuptojë materiale leximi autentike të gjinive të ndryshme;
- të lexojë në mënyrë globale dhe me ndihmën e fjalorit të kuptojë idetë kryesore të teksteve të regjistruara të ndryshëm gjuhësorë;
- të shprehë mendime dhe pikëpamje vetjake për tema të njohura, duke dhënë arsye të qarta për to.

Të shkruarit

- Të shkruajë ese me shumë paragrafë me stil të përshtatshëm;
- të shkruajë në mënyrë të pavarur për tema faktike dhe imagjinare;
- të lidhë me fjalë lidhëse fjali dhe paragrafë;
- të përdorë gjuhën e mësuar më parë me siguri dhe korrektësi.

C. Parime për zbatimin e programit

Vendosja e nxënës/it,-es në qendër të vëmendjes

Nxënës/i,-ja duhet të jetë në qendër të procesit mësimor dhe të gëzojë të drejta të plota pjesëmarrjeje, duke shprehur përvojën e tij/saj jetësore. Kjo do të realizohet:

- Duke përzgjedhur tema, lloje të teksteve dhe forma sociale të orientuara sipas interesave dhe nevojave të moshës së klasës së 12-të.
- Duke pasur parasysh nivelin dhe rezultatet e tyre, qëllimin e këtyre orëve: thellim dhe avancim.
- Duke përdorur strategji që e nxisin nxënës/in,-en të veprojnë me gjuhën.
- Duke e përfshirë nxënës/in,-en në vlerësimin dhe vetëvlerësimin e dijeve të përftuara.

Organizimi i mjedisit të të nxënës

Mësuesit tanë duhet të ndërjegjësohen se është shumë e domosdoshme që nxënësi të ndihet i sigurt. Kjo arrihet nëpërmjet krijimit të një mjedisi shkollor fizik, emocional, sfidues dhe jofrenues për procesin mësimor, mjedis i cili mundëson një mësimdhënie/nxënie që plotëson ndjeshëm nevojat dhe objektivat e përcaktuar më parë.

Organizimi i klasës

Duke dalë nga forma standarde tashmë e vjetruar e mësimdhënies frontale dhe duke e vënë nxënës/in,-en në qendër të vëmendjes, mësuesi do të jetë organizues, furnizues dhe orientues për ta, duke i bërë pjesë aktive dhe jo pasive në mësim. Ai do t'i ndihmojë nxënësit për një të mësuar të qëndrueshëm. Mësuesi ka më tepër rol planifikues, sesa burim i të gjitha njohurive në klasë.

Mësimdhënia ka në qendër të saj metodën komunikative, metoda me bazë detyrën, metoda funksionale dhe atë të situatave sa më afër jetës reale etj.

Mësuesi është i lirë dhe i pavarur në përdorimin e metodave dhe të materialeve mësimore që mbështesin krijimtarinë dhe pavarësinë mendore si të nxënësve, ashtu dhe të mësuesve

Puna në grupe, me partnerë, motivon nxënësit, të cilët mësojnë më tepër nga shkëmbimi i informacionit me njëri-tjetrin. Mësuesi ideon orën e mësimin dhe nxënësit bëhen aktivë nëpërmjet formave bashkëvepruese të mësimdhënies të cilat zgjidhen nga mësuesi.

Të mësuarit bashkëveprues

Format e reja të punës, p.sh., në grupe, me partnerë, i bën nxënësit më bashkëveprues, më tolerantë, i aftëson ata të përdorin forma demokratike në bashkëbisedim. Duke ndarë punën dhe përgjegjësitë, nxënësit mësojnë të shoqërohen dhe të punojnë me të tjerë.

Nxënësit aftësohen drejt pavarësisë në rritje në përfitimin gjuhësor gjatë mësimin të gjermanishtes, e mundësuar kjo nëpërmjet aktiviteteve përkatëse të të mësuarit.

Përdorimi i gjuhës në klasë

Në nivelin gjuhësor B2, nxënësi është më i formuar nga ana gjuhësore e kulturore dhe është i gatshëm të përdorë gjuhën gjermane në situata reale, si p.sh., në kryerjen e veprimtarive gjuhësore, në dhënien e udhëzimeve për punët e përbashkëta në projekte, ku ka ndarje dhe përgjegjësi ndaj detyrave të caktuara.

Të mësuarit e gramatikës

Gjuha gjermane ka si element të rëndësishëm dhe strukturat gramatikore, të cilat nuk duhet të jepen të izoluara, si qëllim në vetvete, por në lidhje me aftësitë gjuhësore dhe me përpunimin e temave dhe të kompetencave leksikore.

Gramatika duhet të konceptohet përgjithësisht në mënyrë deduktive, me qëllim që të nxiten nxënësit drejt një procesi analitik dhe nga mendimi kritik. Kjo do të thotë që nxënësi duhet të dalë vetë nëpërmjet shembujve të shumtë dhe të larmishëm të rregullit gramatikor. Duhet të hiqet dorë nga dhënia paraprake nga mësuesit e rregullave dhe tabelave shabllo.

Duke pasur parasysh synimet e orëve të avancimit, puna me gramatikën duhet të synojë thellimin dhe avancimin e njohurive, konkretisht të nivelit B2; të nivelit C1.

Korrigjimi i gabimeve

Programi i gjuhës gjermane për klasën e 12-të pasqyron më së miri mënyrën më të plotë të korrigjimit të gabimeve nga vetë nxënësi. Niveli B2 parashikon një shkallë më të lartë të saktësisë gjuhësore për të siguruar një komunikim të qartë.

Puna e diferencuar

Thellimi dhe avancimi i njohurive të gjermanishtes bazohet në punën e diferencuar, ku do të përfshihen nxënës që kërkojnë avancim në këtë gjuhë. Duke pasur parasysh përbërjen heterogjene të klasave tona, mësuesi duhet të parapëlqejë punën në grupe. Kështu ai mund të krijojë grupe mikse me nxënës/e të përparuar/a dhe të prapambetur/a, duke caktuar detyra në grup për të mos i vënë në vështirësi këta nxënës dhe për t'i inkurajuar të zgjidhin ato detyra që munden. Mësuesi mund t'u japë gradualisht detyra motivuese e tërheqëse plus për të siguruar një nivelim të tyre me të tjerët, por duke bërë kujdes që të mos rrisë vështirësitë e tyre.

Një motivim i mirë për thellimin e njohurive të gjermanishtes, konkretisht për nxënësit e përparuar, janë veprimtaritë shtesë, si: përzgjedhje e materialeve autentike, krijime me shkrim në kuadër konkurruesh, recitime ose vënie në skenë të pjesëve të ndryshme në gjuhë të huaj etj. Mësuesi mund të përdorë punën e këtyre nxënësve për të realizuar bashkë me ta integrimin lëndor, që është një aspekt shumë i rëndësishëm i metodologjisë së zbatimit të programit. Nxënësit e përparuar mund të sjellin një kontribut të konsiderueshëm nëpërmjet transferimit të njohurive të tyre nga gjuha dhe kultura amtare në gjuhën dhe kulturën e huaj dhe anasjelltas.

7. VLERËSIMI

Zbatimi me korrektesë i udhëzimeve për përdorimin e programit të klasës së 12-të bën të mundur vënien në praktikë të një mënyre vlerësimi bashkëkohore të dijeve të nxënës/it,-es, me bazë vlerësimin komunikativ me shkrim dhe me gojë gjatë gjithë procesit mësimor. Kjo metodë vlerësimi, mbështetur në Kuadrin e Përbashkët European të Referencave për Gjuhët dhe në Portofolin European për Gjuhët, jo vetëm përshkon gjithë procesin mësimor, por shërben dhe për përmirësimin e këtij procesi.

Kur vlerësimi mbështetet në aktivitetet e organizuara në klasë, të parashikuara në program, në përputhje me objektivat e tij, ai siguron:

- Një matje të rregullt të ecurisë së nxënës/it,-es në gjuhën gjermane;
- një informacion për rivlerësim të përmbajtjes lëndore, si dhe cakton detyrat për të ardhmen;
- një përmirësim të njohurive të nxënës/it,-es;
- një përgjegjshmëri të të gjithë pjesëmarrësve në procesin e mësimdhënies/nxënies (nxënës, mësues të gjuhës gjermane dhe ndër-lëndorë, drejtori shkolle, inspektor i arsimit për gjuhën gjermane dhe, detyrimisht, edhe prind).

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit mësimor. Mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënës/in,-en për ata objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në program.

Objektiv i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë, por dhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etiko-sociale, në përgjithësi, dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti. Vlerësimi i nxënës/it,-es duhet të jetë objektiv dhe i matshëm. Asgjë nuk është më nxitës, sesa sukcesi i arritur duke u përballur me gjendjen reale në të cilën ndodhet një nxënës/e. Mësues/i,-ja monitoron dhe vlerëson detyrat, duke përcaktuar objektiva të qartë. Mësues/i,-ja përdor vetë dhe ndihmon edhe nxënësit që të përdorin një larmi mënyrash vlerësimi.

Vlerësimi mund të organizohet në disa forma:

Vlerësimi i dijeve (ose i niveleve), ku përfshihet vlerësimi i objektivave specifike. Ky vlerësim ka lidhje me atë çfarë është mësuar gjatë një jave, një muaji ose një semestri, pra me punën që është bërë me tekstin dhe programin. Vlerësimi i dijës është i bazuar në orën e mësimit. Kështu, ai i përgjigjet një vështrimi të brendshëm. Ky lloj vlerësimi është pozitiv për faktin se është më afër përvojës së nxënës/it,-es

Vlerësimi i kapaciteteve (ose i zbatimit të aftësive, ose i performancës), që është vlerësimi i asaj që nxënësit mund të bëjnë ose dinë në raport me zbatimin e saj në jetën e përditshme dhe i lejon çdonjërit të pozicionohet aty ku e meriton, pasi rezultatet janë më se të dukshme.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Nxënës/i,-ja vlerësohet me notë, ndërsa demonstroi arritjet e tij/saj me gojë, me shkrim, ose nëpërmjet veprimtarive e produkteve të tjera, si një maket etj.

Vlerësimi me shkrim dhe me gojë klasifikohet në:

Vlerësim formues, me anë të të cilit merret informacion rreth asaj që është arritur nga nxënës/i,-ja në formimin e tij/saj gjuhësor, në përputhje me objektivat e caktuar.

Vlerësim diagnostikues, i cili bëhet në mënyrë të vazhdueshme, për të marrë informacion rreth përgatitjes ditore dhe rreth përvetësimit të materialit gjuhësor të dhënë më parë. Gjithashtu, ai jep informacion për efektivitetin e të nxënësit dhe ndihmon në ecurinë e mëtejshme të mësimdhënies/nxënies.

Vlerësim i planifikuar mbi bazën e realizimit të objektivave të fushës, pra në bazë kapitulli. Ky vlerësim bëhet me notë dhe realizohet në fund të çdo mësimi përsëritës.

Vlerësim motivues ndihmon për të nxitur dëshirën e nxënës/it,-es për mësimin e gjuhës gjermane. Ky vlerësim është i vazhdueshëm dhe gjatë gjithë procesit mësimor. Mësues/i,-ja realizon këtë lloj vlerësimi duke gjetur shprehjet e duhura motivuese, si p.sh.: *mirë, shumë mirë,*

all right etj., dhe duke përdorur materiale që nxisin vlerësimin motivues të nxënësit, p.sh., përgatitja e dosjes së arritjeve të nxënës/it,-es si pjesë e portofolit evropian të gjuhëve, ku ai vendos certifikata, provime, projekte, dëshmi etj., që provojnë ecuri të tij në gjuhë.

Vlerësimi përfundimtar

Në përfundim të semestrit të parë, për çdo nxënës/e dhe lëndë përllogaritet nota semestrale dhe në përfundim të vitit shkollor, nota vjetore. Nota e semestrit të parë dhe ajo vjetore përllogariten duke pasur si të dhëna fillestare të gjitha notat e nxënës/it-es të shënuara në regjistër. Notat gjatë vitit shkollor nuk kanë të njëjtën peshë në njehsimin e notës semestrale dhe të asaj vjetore. Pesha e një note përcaktohet nga lloji i saj.

Dallojmë katër lloje notash:

- nota e vlerësimeve të përditshme,
- nota e provimeve periodike me shkrim,
- nota e punimeve të nxënësve,
- nota e provimit përfundimtar (nëse mësuesi e zhvillon edhe këtë).

Duhet treguar kujdes që:

- Para testimit duhet dhënë një model, që t'u tregohet nxënësve se si do të bëhet testimi.
- Caktohen më parë qëllimet e testimit për të kaluar më pas në zhvillimin e tij.
- Vlerësimi mund të jetë individual ose në grup.
- Në rastet kur testet hartohen me pyetje të llojeve të ndryshme, ato grupohen sipas llojit të tyre, p.sh.: pyetje me zgjedhje të shumëfishtë bashkë, ato me çiftim bashkë e kështu me radhë.

Disa udhëzime për vlerësimin

Është e domosdoshme që mësues/i,-ja të mos përdorë vetëm një formë vlerësimi, por larmi formash. Ato duhet t'u krijojnë nxënësve mundësi të vlerësohen në atë mënyrë që është e përshtatshme për çdo individ. Kështu, p.sh., një nxënës/e përgjigjet më mirë me gojë, një tjetër me shkrim, njëri i shpreh bukur dhe me emocion mendimet në një pyetje të hapur, një tjetër jo dhe e ka të lehtë në pyetjet e mbyllura etj.

Vlerësimet e përfundimeve të nxënësve të trajtohen me kompetencë e jo si mesatare aritmetike e notave të vlerësimit formues.

Të kihet parasysh që përparimi i nxënës/it,-es dhe një gjykim përmbledhës në përfundim të periudhës, bazuar në objektiva, përbën vlerësimin përfundimtar. Vonesat e dhënies së përfundimeve të vlerësimit dhe analiza e tyre nga mësues/i,-ja e ulin shumë vlerën e korrigjimit të gabimeve.

Shënimet të jenë të thjeshta, por të pasura. Është e domosdoshme që, përveç regjistrimit të klasës, mësues/i,-ja të mbajë shënime të tjera për punën e çdo nxënës/i,-eje. Ato ndihmojnë në njohjen dhe në vlerësimin e arritjeve, në diagnostikimin e në riparimin e vështirësive dhe lehtësojnë vlerësimet përmbledhëse.

Vlerësimi i nxënësit përshkon gjithë procesin mësimor dhe shërben për përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi i nxënësit nuk ka për qëllim të vetëm vendosjen e notës dhe as nuk përfundon me vendosjen e saj.

Vlerësimi në lëndën e gjuhës se huaj do të fokusohet në aftësinë e zotërimit të koncepteve kyç të gjuhës së huaj dhe të përdorimit të këtyre koncepteve. Vlerësimi i aftësive do të vëre theksin në sjelljen e nxënësve në një punim të caktuar, sjelljen në grup dhe aftësinë e tyre për të përdorur burime të ndryshme për marrjen e informacionit në gjuhë të huaj, si dhe vlerësimin në mënyrë kritike të këtij informacioni.

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit mësimor. Mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënësit për ata objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në program.

Objektiv i vlerësimit nuk janë vetëm njohuritë dhe aftësitë, por dhe qëndrimet e nxënësve, si qëndrimet etike e sociale, në përgjithësi, dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti.

Mësues/i,-ja zhvillon vetë, si dhe ndihmon nxënësit dhe, së bashku, zhvillojnë një larmi mënyrash vlerësimi.

Metodat e vlerësimit të përdorura në gjuhë të huaj do të përfshijnë:

- Teste me shkrim për të kontrolluar arritjet e nxënësve në lidhje me objektivat e programit,
- monitorimin e punës në grup të nxënësve,
- punët eksperimentale, raportet e punës,
- projektet, prezantimet e kërkimeve.

Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Mësues/i,-ja nuk e ka të detyrueshëm vlerësimin me notë të nxënësve në çdo orë mësimore.

Si rregull, nxënësit dhe mësuesit duhet të bashkëbisedojnë lirshëm si partnerë rreth përvetësimit të materialeve mësimore të zhvilluara në klasë dhe kryerjes së detyrave jashtë klase. Herë pas here, mësues/i,-ja duhet të vlerësojë me notë, duke ua bërë të qartë nxënësve, që në fillim, qëllimin e vlerësimit dhe kriteret e tij.

Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e nxënësve në komunikimin me shkrim dhe mund të realizohet jo vetëm me laps e letër, por edhe në rrugë elektronike. Mësues/i,-ja vlerëson nxënës/in,-en me notë për parashtrimet me shkrim në provimet periodike me shkrim dhe në prezantimet me shkrim të punimeve të tij/saj, të zhvilluara vetë ose në grup. Mësues/i,-ja planifikon provime periodike me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore, që përbëhen nga një apo disa kapituj, të cilët i bashkojnë objektiva të ndërlidhur të të nxënësve. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim, ai/ajo përdor lloje të ndryshme testesh, që nga testet disaminutëshe për një objektivi të veçantë të nxënësve, tek ato njëorëshe. Planifikohen teste me alternativa ose zhvillim, detyra tematike, projekte kurrikulare etj.

Vlerësimi në gjuhë të huaj do të fokusohet në aftësitë e nxënësve në lidhje me të kuptuarit dhe përdorimin e këtyre njohurive.

Portofoli i nxënës/it.-es, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimi, është një koleksion i punimeve përgjatë vitit shkollor. Portofoli i nxënës/it.-es mund të përmbajë provime me shkrim, detyra tematike, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënës/i,-ja, ndërsa mësues/i,-ja rekomandon.

Çrregullime të diagnostikuara, si: disleksia, vështirësi të veçanta gjuhësore, p.sh., të nxënësve të ardhur rishtas nga emigracioni, merren parasysh nga mësues/i,-ja, duke u mundësuar këtyre nxënësve të vlerësohen me mënyra të posaçme, përjashtuar vlerësimin me shkrim apo me gojë.

Në punime të nxënësve me grupe të vogla, mësuesi parashtron peshën e vlerësimit me notë të grupit në tërësi dhe të secilit nxënës në veçanti, sipas detyrave të tij/saj në grup.

Vetëvlerësimi

Vetëvlerësimi është një tjetër element i rëndësishëm i vlerësimit në mësimin e gjuhës gjermane, ku secili nxënës/e jep gjykimin për zotësinë e vet. Vetëvlerësimi është një plotësues i domosdoshëm i vlerësimit nga mësues/i,-ja dhe nga provimet, madje dhe nga prindërit e nga institucione të tjera vlerësuese.

Vetëvlerësimi ka efekt, kur:

- U referohet normave dhe kapacitetit që Kuadri i Përbashkët i Referencave për Gjuhët parashtron për grupmoshën e nivelin e tyre,
- është i lidhur me një përvojë të veçantë gjuhësore e ndërkulturore.

Vënia e synimeve të qarta në program mundëson vetëvlerësimin në vazhdimësi. Si mjet në vlerësim dhe vetëvlerësim shërben Portofoli European i Gjuhëve (PEGj) që, me anë të tri pjesëve të tij (Pasaportës Gjuhësore, Bibliografisë Gjuhësore dhe Dosjes), nxit nxënësin të mendojë mbi nivelin e tij gjuhësor, duke vetëvlerësuar njohuritë e marra, dhe të dokumentojë arritjet e tij gjuhësore, të cilat mund të jenë: provime me shkrim, detyra tematike, certifikata, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare.

PEGj-i është dokumenti që çdo nxënës që mëson një gjuhë ose ka mësuar një gjuhë, në shkollë ose jashtë saj, mund të shënojë njohuritë e tij gjuhësore dhe eksperiencat kulturore. PEGj-i nxit çdo nxënës të mësojë më shumë gjuhë, edhe në nivele modeste, dhe të vazhdojë t'i mësojë ato gjatë gjithë jetës. PEGj-i nxit nxënësin të përmirësojë mësimin dhe kapacitetin e vlerësimit të aftësive të tij në fushën e gjuhëve. Përdorimi i PEGj-it favorizon lëvizjen në Europë, duke informuar aftësitë për gjuhët në mënyrë të qartë dhe të krahasueshme në nivel ndërkombëtar. PEGj-i kontribuon në mirëkuptimin reciprok në Europë nëpërmjet eksperiencës së kulturave të tjera dhe me ndihmën e kapaciteteve të komunikimit në shumë gjuhë.

- Nxënësit vlerësojnë punën e tyre në çifte. Më pas, mësues/i,-ja dhe nxënësit bëjnë komentimin përfundimtar.
- Nxënësit, gjithashtu, vlerësojnë punën e njëri-tjetrit në grupe, duke marrë role të ndryshme, madje dhe pa nevojën e ndihmës së mësuesit.
- Nxënës/i,-ja mban shënim arritjet e tij/saj, duke përdorur edhe gjuhën amtare.
- Mësues/i,-ja bisedon me nxënës/in,-en individualisht dhe i tregon arritjet.
- Interesi më i madh i vetëvlerësimit qëndron në faktin se ai është faktor motivimi dhe ndërgjegjësimi; ai i ndihmon nxënësit të njohin pikat e tyre të forta dhe të dobëta dhe, kështu, të organizojnë më mirë të nxënësit e tyre. Nga vetëvlerësimi përfiton si nxënës/i,-ja, ashtu dhe mësues/i,-ja.